



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

<b>Datë/a:</b>	04.12.2020
<b>Referenc-ë:</b>	
<b>Për/ Za/ To:</b>	OJQ Shtëpia e Shpresës- Alban Krasniqi
<b>Përmes/Preko/Through:</b>	Drejtoris së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtarë për hapësira publike <i>Haskoti</i> Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit <i>Haskoti</i>
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	<b>Pëlqim</b>

Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën përmes emailit zyrtar nga OJQ Shtëpia e Shpresës me përfaqësues Alban Krasniqi të cilët kërkojnë shfrytëzimin e hapësirës publike në Sheshin “Nëna Terezë”.

Qëllimi i aktivitetit është hulumtimi i situatës aktuale dhe vjetore nëpër të cilën kemi kaluar si vend ku do të vendoset një baner në të cilin do të shënohen mesazhe nga qytetarët.

Drejtoria pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohëshme në pronën publike nr.01-110-157481, i jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike me datën 08 dhe 09 Dhjetor 2020 në Sheshin “Nëna Terezë” nga ora 10:00 deri në 18:00.

**Kushtet e pëlqimit:**

- nuk lejohet grumbullimi në hapësirë publike më shumë se pesë(5) persona;
- të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës ;
- varësishtë nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.

